



PROCESVERBAL
Nga mbledhja e VI-të për vitin 2012, e Kuvendit Komunal në
Vushtri, mbajtur më 28.6.2012

Mbledhja është mbajtur në sallën e kuvendit komunal duke filluar në orën **10:10**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri: Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Esat Beka, Ferit Idrizi, Gani Imeri, Habib Mustafa, Habibe Gërzhaliu, Hajrulla Muli, Islam Krasniqi, Ismet Gashi, Makfirete Ademi, Merjeme Ismajli, Melihate Basholli, Muharrem Shabani, Naile Osmani, Nysret Gërzhaliu, Pajazit Pllana, Qazim Azemi, Refik Ramaj, Remzije Isufi, Sabit Kadriu, Sabri Ferati, Selim Rustemi, Selvete Sholla, Shpëtim Zhegrova, Syzana Sylja, Tasim Gubetini, Veli Karaça, Vlora Qirezi, Xhemajl Pllana, Xhylsime Feka dhe Zeqir Hasani.

Munguan: Avdullah Halimi, Ergin Sunguri, Besim Jashari, anëtarë të kuvendit.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: kryetari i komunës, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të ICO-së (Zyra Civile Ndërkombëtare), dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Habib Mustafa - kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë.

Habib Mustafa, kryesues i kuvendit- paraqiti rendin e ditës ashtu siç është paraparë në ftesë.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të LDK-së propozoi që të shtohen në “të ndryshme” dy pika:

a. Informatë për pastërtinë në qytetin e Vushtrrisë;

b. Informatë për furnizimin me ujë të pijshëm në qytetin e Vushtrrisë.

Gjithashtu kërkoi që pika nr. 8 të hiqet nga rendi i ditës, pasi që kërkesa në fjalë iu është adresuar kryetarit të komunës.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- duke iu referuar pikës nr. 8 të rendit të ditës, sqaroi se sipas Rregullores për Subvencione kryetari i komunës nuk ka të drejtë të ndajë mjete më shumë se 500 €.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- propozoi që në “të ndryshme” të futet çështja e restaurimit dhe përfundimit të Kullës së Azem Bejtës, pasi që është edhe 100 vjetori i

Pavarësisë së Shqipërisë, duke propozuar që në vigjilje të 28 Nëntorit, të organizohet një manifestim dhe të bëhet hapja e kullës në fjalë. Pastaj pyeti drejtorin e kulturës pse nuk është mbajtur në muajin maj të këtij viti manifestimi “Takimet e Poeteshave Shqiptare”, prandaj kërkoi një informatë për çështjen në fjalë nga drejtori i kulturës. **Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit**- tha se Grupi parlamentar i PDK-së e përkrah rendin e ditës, kurse lidhur me pikën nr. 8 të rendit të ditës, tha se kjo pikë ka kaluar edhe përmes KPF-së, kurse dy informatat që u propozuan që të futen në “të ndryshme”, tha se kërkojnë kohë të përgatiten, prandaj propozoi që të hyjnë në mbledhjen e radhës së KK-së.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- tha se Grupi parlamentar i AAK-së pajtohet me rendin e ditës, gjithashtu pajtohemi që të futen pikat shtesë të propozuara më parë, e sidomos diskutimi për çështjen e furnizimit me ujë të pijshëm, para se të shkaktohet ndonjë epidemi. Gjithashtu propozoi që për mbledhjen e ardhshme të KK-së të futet në rend dite çështja e sigurisë, sepse nëse në një qytet që tregtohet me qenie njerëzore, nuk mund të thuhet se ka siguri, duke propozuar që të ftohet në mbledhje të KK-së edhe komandanti i Stacionit Policor të Vushtrrisë.

Habib Mustafa, kryesues i kuvendit- propozoi që rendit të ditës, në “të ndryshme” t’i shtohen edhe propozimet e R.Ramajt dhe S.Kadriut.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, kuvendi me 26 vota “për”, të tjerat “abstenim” miratoi këtë:

R E N D I T E

- 1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.**
- 2. Shqyrtimi i Qarkores Buxhetore të Komunës 01/2013 (fillimi i planifikimit të buxhetit).**
- 3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ridestininimin e mjeteve të lira buxhetore.**
- 4. Shqyrtimi i Draft-rregullores për caktimin e kritereve dhe mënyrën e ndarjes së shpërblimeve, mirënjohjeve, dekoratave dhe titujve të nderit (shqyrtimi i dytë).**
- 5. Shqyrtimi i Informatës mbi përgatitjet për fushatën e korrje-shirjeve.**
- 6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Qendrës për aftësim profesional (fshati Maxhunaj).**
- 7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin Qendrës për fëmijët parashkollor (në fshatin Gracë).**
- 8. Shqyrtimi i kërkesës së OVL - UÇK-së, dega në Vushtrri për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 5.000 € për shënimin e ditës së Zonës Operative të Shalës.**
- 9. Të ndryshme:**
 - a. Informatë për pastërtinë në qytetin e Vushtrrisë;**
 - b. Informatë për furnizimin me ujë të pijshëm në qytetin e Vushtrrisë;**
 - c. Informatë rreth restaurimit dhe përfundimit të Kullës së Azem Bejtës;**
 - ç. Informatë lidhur me manifestimin “Takimet e Poeteshave Shqiptare”.**
 - d. Pyetjet eventuale të anëtarëve të kuvendit.**

- 1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.**

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të AAK-së propozoi që të plotësohet procesverbali në fjalë, te pika 11 “a” e rendit të ditës dhe shtoi se kanë qenë dy propozime, por nuk janë paraqitur sipas rrjedhës reale, duke

propozuar që të përmendet edhe votimi, d.m.th. sa kanë qenë “për” dhe sa “kundër”.

Aprovohet në mënyrë unanime procesverbali i mbledhjes së KK-së, me vërejtjen e Q.Azemit.

2. Shqyrtimi i Qarkores Buxhetore të Komunës 01/2013 (fillimi i planifikimit të buxhetit).

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa- paraqiti sqarimet hyrëse.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- duke iu referuar qarkores buxhetore në fjalë, tha se nëse bëhen krahasime në mes të komunave: Suharekë, Podujevë dhe Vushtrri, ka disa disproporcione në mes të granteve dhe të hyrave vetjake. Pastaj tha se është pozitive që po bëhet një shqyrtim publik për buxhetin, kurse shqetësuese është që shqyrtimi nuk po shkon në të gjitha bashkësitë lokale.

Khylsime Feka, anëtare e kuvendit- tha se qarkorja buxhetore në fjalë është një informacion paraprak për përgatitjen e planifikimit të buxhetit komunal, në të cilën janë vënë konturat dhe limitet se sa dhe si do të mund të planifikohen projektet për vitin e ardhshëm. Pastaj tha se nga qarkorja buxhetore nënkuptohet se qeveria bën çmos për ta ruajtur stabilitetin buxhetor. Gjithashtu tha se është pozitive që qeveria ka ndarë mjete të veçanta për reformimin e administratës publike, por është brengosëse shuma e granteve specifike për arsim dhe shëndetësi, pasi që në këta dy sektorë ka kërkesa të mëdha, sidomos sektori i shëndetësisë.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- tha se qarkorja buxhetore ka rëndësi dhe peshë të madhe për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë lidhur me zhvillimin e Komunës së Vushtrrisë, prandaj është e nevojshme që të zhvillohet një diskutim thelbësor në mënyrë që në fund të paraqitet një propozim konkret për të gjitha mjetet buxhetore. Gjithashtu propozoi që të ngritet zëri dhe të trajtohet Komuna e Vushtrrisë në mënyrë të barabartë me komunat tjera, në proporcion me numrin e banorëve. Pastaj lidhur me caktimin e prioritetëve, tha se edhe në të kaluarën kemi kërkuar që të kenë prioritet pagesit e tatimit të pronës dhe ato mjete t’iu kthehen përmes projekteve të caktuara, të cilat e përmirësojnë jetën e tyre.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- tha se nga qarkorja buxhetore nënkuptohet se ministria ka caktuar strategji për komunat, prandaj komunat e kanë obligim që të hartojnë plane që do të çojnë në zhvillimin e gjithëmbarshtëm të komunës. Pastaj tha se në Komunën e Vushtrrisë janë ndërtoar shkollat, por për vitet e ardhshme propozoi që të fokusohemi në ngritjen e cilësisë në procesin edukativo-arsimor, pasi që për të pasur cilësi duhen investime, duke shtuar se duhet të investohet në paisjen e laboratorëve të kimisë, biologjisë, fizikës dhe disa lëndëve që janë teknike, por edhe në fushën e bujqësisë. Gjithashtu propozoi që të fokusohemi në paisjen e shkollave me biblioteka dhe me libra. Në vazhdim propozoi që për vitin e ardhshëm të ndërrohet skema e organizimit të pushtetit lokal dhe Sektori i Bujqësisë të ngritet në drejtori, dhe shtoi se për zhvillimin e bujqësisë, komuna duhet të jetë në kontakt të vazhdueshëm me Drejtorinë e sistemit të Ibër-Lepencit, pasi që tokat që janë nën ujitje, por që nuk mund të shfrytëzohen për shkak të defekteve, të eliminohen defektet, dhe e tërë toka që ka qenë e planifikuar të ujitet, duhet të ujitet. Mandej tha se është e padrejtë që Komuna e Vushtrrisë është krahasuar me Komunën e Suharekës, prandaj kërkoi nga kryetari i komunës që ta ngrisë zërin për çështjen në fjalë. Në fund, lidhur me mjetet e ndara për shëndetësi, tha se spitali është nën kompetencat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe shtoi se këto mjete që janë ndarë për Vushtrrinë nuk mjaftojnë, pasi që në kuadër të Vushtrrisë funksionon edhe spitali (i pajisur me mjete moderne nga Emiratet e Bashkuara Arabe) do të ishte tragjike sikur të mos funksionojë me kapacitetin e plotë, prandaj propozoi që përfaqësuesit e

Komunës së Vushtrrisë duhet ta ngrisin zërin që të derdhen më shumë mjete se sa ato që janë parashikuar në qarkoren buxhetore për Sektorin e Shëndetësisë në Vushtri.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- duke iu referuar qarkores buxhetore, njoftoi se ka reaguuar në vitet paraprake në Ministrinë e Financave, për mënyrën e ndarjes së buxhetit, pasi që kjo mënyrë nuk është e qëndrueshme, prandaj duhet të ekzistojë një ligj apo rregullore në Ministrinë e Financave që e përcakton ndarjen e buxhetit. Pastaj tha se janë dy projekte të USAID-it që po na ndihmojnë për të hartuar dy programe për Komunën e Vushtrrisë: Programi për hartimin e kornizës afatmesme buxhetore dhe Programi për hartimin e planifikimit për vitin 2013, me ç'rast shtoi se Komunës së Vushtrrisë po i mungon strategjia afatmesme zhvillimore e komunës, prandaj duhet të punohet në këtë drejtim.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Ipet në diskutim publik Qarkorja Buxhetore e Komunës së Vushtrrisë 01/2013.

Diskutimi publik fillon nga data 29.06.2012 dhe zgjatë deri më 27.08.2012.

3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ridestinimin e mjeteve të lira buxhetore.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa- paraqiti sqarimet hyrëse.

Xhemajl Pllana, anëtar i kuvendit- njoftoi se një rrugicë e ngushtë e cila çon në lagjen "Pllana" dhe te varrezat e fshatit Shtruherë ka disa vite që është në prioritet për asfaltim, por me gjithë premtimet e shumta edhe pse është ndërtuar rruga kryesore e fshatit dhe dy anekse tjera, kurse edhe rrugica në fjalë është aneks i kësaj rruge, por akoma nuk është ndërtuar, prandaj pyeti se a është i njoftuar kryetari i komunës për këtë gjë, dhe shtoi se nëse është hakmarrje që ka kaluar në një subjekt tjetër politik pa fajin e tij, tha se familjet që banojnë në atë lagje nuk e meritojnë një trajtim të tillë nga Komuna e Vushtrrisë.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- duke iu referuar pyetjes së Xh.Pllanës, tha se projekti në Shtruherë është në realizim e sipër dhe është e vërtetë që është tejkalluar rrugica e lagjes "Pllana", prandaj shprehu keqardhjen e tij për çështjen në fjalë dhe shtoi se projekti akoma nuk ka përfunduar, por edhe nëse nuk kryhet e tërë rrugica, një pjesë e saj gjithsesi do të kryhet.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit 31 vota "për", 1 "abstenim" vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim lejohet ridestinimi i mjeteve të lira buxhetore në investime kapitale në programin e Drejtorisë për Arsime dhe në programin e Drejtorisë për Urbanizim dhe Mbrojtje të Mjedisit.

4. Shqyrtimi i Draft-rregullores për caktimin e kriterëve dhe mënyrën e ndarjes së shpërblimeve, mirënjohjeve, dekoratave dhe titujve të nderit (shqyrtimi i dytë).

Veli Karaça, anëtar i kuvendit- tha se për draft-rregulloren në fjalë është diskutuar edhe në KPF, por asgjë nuk është inkuorporuar në të. Pastaj tha se kjo rregullore nuk e ndihmon organin i cili merret me vlerësimin e kriterëve për ndarjen e mirënjohjeve, pasi që nuk është përgatitur siç duhet, sepse nuk janë ndarë kompetencat e organeve komunale (kryetarit dhe kuvendit), por edhe formulimi i neneve nuk është i qartë. Në vazhdim paraqiti vërejtjet për këto nene: te neni 4, duhet të ceket për çfarë motivacioni dhe për çfarë rezultati jepet dhe mënyra e dhënies, si dhe për çfarë vlere ndanë kryetari dhe për çfarë vlere kuvendi, dhe kush e merr vendimin

për cilën shumë. Po ashtu të ceket se për cilat motivacione duhet të merrë vendim kryetari, e për cilat kuvendi; te neni 5, askund nuk ceket që edhe kuvendi ndanë mirënjohje; te neni 6.1, tha se mund të jepet edhe në rastet tjera, kurse te fjalia “kontribut më përfshirës” duhet të ceket për çfarë kontributi është fjala; te neni 6.2, propozoi që të mos përjashtohen edhe qytetarët e Vushtrrisë kur bëhet fjalë për ndonjë rezultat të jashtëzakonshëm dhe mund të jepet edhe për kontribut kombëtar apo shtetëror; te neni 6.3, propozoi që të shtohen kategoritë nga shoqëria civile, arti dhe biznesi, dhe shtoi se këtu nuk është paraparë fare ndarja e plaketave; neni 7 dhe neni 9 janë të ngjashëm, kurse te neni 7 në vend të fjalisë “në bazë të kontributit” duhet të thuhet “për kontributin”; te neni 8, në vend të fjalisë “për miratim” duhet të thuhet “për shqyrtim dhe aprovim”; neni 9 duhet të hiqet i tëri; te neni 10, tha se këto iniciativa mund të vijnë edhe nga qytetarët; te neni 11, duhet të ceket edhe kontributi më i gjerë që tejkalon territorin e Komunës së Vushtrrisë; te neni 11 propozoi që të hiqet paragrafi nën “c”; kurse neni 11 nën “d” duhet të riformulohet dhe të fshihet fjala “procesi”; te neni 11 nën “e” fjalia “me të arriturat” duhet të ndërrohet; te neni 12 duhet të ceket se te kush duhet të adresohen propozimet; te neni 14, tha se kuvendi si organi më i lartë nuk mund të anashkalohej; te neni 15, duhet të thuhet “vendi dhe koha e ndarjes”, sepse dekoratat mund të ndahen edhe pa ceremoni.

Xhyllime Feka, anëtare e kuvendit- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, paraqiti këto vërejtje: te neni 2, ku thuhet “...kompetencë e komunës...”, shtoi se komuna është e ndarë në legjislativ dhe ekzekutiv, prandaj duhet të ceket në nenin në fjalë; te neni 3, në vend të fjalisë “dhënia e shpërblimeve” duhet thënë “ndarja e shpërblimeve”; te neni 4 duhet të ceket që shpërblimi duhet të jepet përmes xhironlogarisë; te neni 15 në vend të fjalisë “ceremonia e dhënies” duhet të thuhet “ceremonia e ndarjes”. Në fund propozoi që draft-rregullorja në fjalë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme të KK-së.

Pajazit Pllana, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, propozoi që vetëm 5 dekorata të ndahen brenda një viti. Kurse dekoratat “Qytetar Nderi” dhe “Çelësi i Qytetit” mbesin çështje alternative. Pastaj propozoi që të shtohen dy paragrafë që të inkorporohet ndarja e plaketave dhe e mirënjohjeve, duke propozuar që brenda një viti kalendarik të ndahen 5 plaketa dhe 10 mirënjohje.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- propozoi që të formohet një komision, i cili do të merret me korigjimin dhe plotësimin e draft-rregullores në fjalë, në mënyrë që të përgatitet për mbledhjen e KPF-së dhe për mbledhjen e ardhshme të KK-së, dhe komisioni të jetë në këtë përbërje: Veli Karaça nga LDK-ja, Sabit Kadriu nga LB-ja, Qamil Sahiti nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- pasi falënderoi kryetarin e komunës që e propozoi për të qenë pjesë e komisionit, njoftoi se për shkak të disa angazhimeve nuk mund të jetë pjesë e komisionit. Pastaj shtoi se për çdo propozim për ndarje të dekoratave, plaketave dhe mirënjohjeve duhet të ketë motivacion.

Esat Beka, anëtar i kuvendit- propozoi për komision Ferit Idrizin nga PDK-ja.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- propozoi për komision Bahrije Pllanën nga AAK-ja.

Selim Rrustemi, anëtar i kuvendit- propozoi për komision Melihate Bashollin nga PDK-ja.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim emërohet komisioni për plotësimin e Draft-rregullores për caktimin e kritereve dhe mënyrën e ndarjes së mirënjohjeve, dekoratave dhe titujve të nderit, në këtë përbërje:

1.1 Ferit Idrizi, PDK;

1.2 Melihate Basholli, PDK;

1.3 Veli Karaça, LDK;

1.4 Bahrije Pllana, AAK;

1.5 Qamil Sahiti, drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

5. Shqyrtimi i Informatës mbi përgatitjet për fushatën e korrje-shirjeve.

Nasuf Aliu, drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural-paraqiti sqarimet hyrëse.

Në vazhdim u diskutuan së bashku këto dy pika të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Qendrës për aftësim profesional (fshati Maxhunaj).

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e objektit të Qendrës për Aftësim Profesional në fshatin Maxhunaj, në ngastrën kadastrale nr. 504, e cila gjendet në oborrin e shkollës fillore "Rilindja" në fsh. Maxhunaj, në sipërfaqe prej 0,25.00 ha, pjesë nga sipërfaqja e përgjithshme 2.41.45 ha, fleta poseduese UL-70202046-00154, ZK Maxhunaj, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Qendrës për fëmijët parashkollor (në fshatin Gracë).

Qerim Selimi, drejtor i Drejtorisë për Arsimit- paraqiti sqarimet hyrëse për dy pikat e rendit të ditës.

Vlora Qirezi, anëtare e kuvendit- tha se Grupi parlamentar i LDK-së i mbështet dy propozim-vendimet në fjalë.

Islam Krasniqi, anëtar i kuvendit- tha se këshilli i arsimtarëve dhe fshati Maxhunaj ia kanë bërë një kërkesë komunës që të mos ndërtohet shkolla në lokacionin (afër shkollës tjetër) që po dëshiron ta ndërtojë investitori, sepse shkolla e fshatit Maxhunaj ka nevojë të rindërtohet, pasi që është shumë e vjetër dhe propozoi që shkolla e re të ndërtohet afër ambulantsës, pasi që ka lokacion të mjaftueshëm, në mënyrë që të mos e kenë të njëjtën hyrje të dy shkollat. Në fund tha se çdo ndërtim është i mirëseardhur, por për ndërtimin në fjalë propozoi që të konsultohen edhe banorët e fshatit Maxhunaj.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- tha se shkolla profesionale që po ndërtohet do të financohet tri vite, dhe pas këtyre viteve mund të ndodh që të mos jetë më e nevojshme kjo shkollë, dhe pastaj mund të shndërrohet në shkollë fillore, dhe shtoi se drejtori i arsimit dhe drejtori i kadastrit është konsultuar me drejtorin e shkollës dhe me mësimdhënësit për ndërtimin e shkollës në fjalë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e Çerdhes së Fëmijëve parashkollor (multietnik), e cila do të ndërtohet në fshatin Gracë, në ngastrën kadastrale nr. 512-1, në sipërfaqe prej 0,15.00 ha, pjesë nga sipërfaqja e përgjithshme 5.36.93 ha, fleta poseduese UL-702022-N-00001, ZK Gracë, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

8. Shqyrtimi i kërkesës së OVL - UÇK-së, dega në Vushtrri për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 5.000 € për shënimin e Ditës së Zonës Operative të Shalës.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- tha se Grupi parlamentar i PDK-së e përkrah kërkesën në fjalë. Gjithashtu në emër të grupit parlamentar propozoi që për vitet e ardhshme këto mjete të ndahen me planifikim buxhetor.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- propozoi që në vitet e ardhshme të gjendet një vijë buxhetore te subvencionet për t'i ndarë mjete buxhetore OVL e UÇK-së.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 19 vota “për”, 4 “abstenim” vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim lejohen mjete financiare nga fondi për subvencione në llogari të Organizatës së Veteranëve të luftës së UÇK-së, dega në Vushtrri, në shumën prej 5.000 € (pesë mijë euro) për shënimin e ditës së formimit të Brigadës së UÇK-së – Zona Operative e Shalës (28.06.2012).

9. Të ndryshme:

- a. Informatë për pastërtinë në qytetin e Vushtrrisë;**
- b. Informatë për furnizimin me ujë të pijshëm në qytetin e Vushtrrisë;**
- c. Informatë rreth restaurimit dhe përfundimit të Kullës së Azem Bejtës;**
- ç. Informatë lidhur me manifestimin “Takimet e Poeteshave Shqiptare”;**
- d. Pyetjet eventuale të anëtarëve të kuvendit.**

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- duke iu referuar çështjes së higjienës së rrugëve, tha se gjendja e higjienës nëpër rrugë është më e mirë se sa në të kaluarën, kurse bashkëpunimi i komunës me kompaninë “Uniteti” nuk është në nivelin e dëshiruar, përkundër faktit që institucioni i komunës po i ofron kushte, duke theksuar se ndihma e fundit nga komuna është bërë duke i kushtëzuar qytetarët. Pastaj tha se shumë herë ka propozuar që të hiqen kontejnerët (veçanërisht në qytet) pasi që ato janë deponi e mbeturinave dhe shtoi se në disa lagje kanë filluar që t'i nënshkruajnë kontratat në mes të qytetarëve dhe kompanisë për mbledhjen e mbeturinave shtëpi për shtëpi. Gjithashtu tha se për mbajtjen e higjienës nëpër rrugët e qytetit ka kontribuar edhe njësitë e zjarrfikësve, po ashtu përmendi edhe fillimin e realizimit të disa projekteve për gjelbërimin e qytetit. Në vazhdim tha se çështje problematike mbetet furnizimi me ujë të pijshëm për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë me ç’rast tha se fabrika e ujit është duke u ndërtuar me një dinamikë të shpejtuar dhe vitin e ardhshëm do të finalizohet ndërtimi i saj, kurse furnizimi me ujë prej kompanisë regjionale të ujësjellësit nga Mitrovica është tepër i dobët, sidomos gjatë sezonës verore, dhe shtoi se ka shumë kyçje ilegale në gypin e ujësjellësit që i dedikohet furnizimit me ujë të qytetarëve të Vushtrrisë. Tutje njoftoi se Komuna e Vushtrrisë disa herë ka reaguar edhe zyrtarisht për këtë problematikë dhe konstatoi se Komuna e Vushtrrisë është në gjendje të rëndë lidhur me furnizimin me ujë të pijshëm. Në vazhdim e mbështeti propozimin e S.Kadriut dhe shtoi se punimet e “vrazhda” për ndërtimin e Kullës së Azem Galicës kanë përfunduar, por nuk kemi ndonjë projekt për rregullimin e ambientit përreth kullës, duke njoftuar se ka edhe varreza të dëshmorëve tjerë që kanë rënë së bashku me Azem Galicën, prandaj ka nevojë që edhe ato varreza të rregullohen, dhe një problem tjetër është pamundësia e bartjes së eshtrave të Shotë Galicës edhe pse është bërë kërkesë në ministri, por akoma po prolongohet. Në fund njoftoi se kanë bërë kërkesë edhe për bartjen e eshtrave të Hasan Prishtinës.

Qamil Sahiti, drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport- tha se kur të bëhet hartimi i planit strategjik për zhvillimin ekonomik, propozoi që në një kaptinë të veçantë të përfshihet trashëgimia kulturore, pasi që në këtë mënyrë do të

përmirësohet edhe performanca e të hyrave në Komunën e Vushtrrisë. Kurse lidhur me takimin e poeteshave, tha se në pajtim me poeteshat është vendosur që enkas për këtë vit të shtyhet takimi i poeteshave shqiptare për muajin shtator, në mënyrë që të mbahet në vigjilje të 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë. Ndërsa lidhur me Kullën e Azem Galicës, tha se kanë negociuar me një kompani që e ka kontratën me komunën për të hartuar një projekt brenda dhe jashtë kullës.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- lidhur me furnizimin me ujë, propozoi që të ketë angazhim maksimal dhe të merren masa që të furnizohen qytetarët gjatë ditës nëpër vende të caktuara përmes “autobotëve”. Pastaj kërkoi nga kryetari i komunës vendimin që është aprovuar në parim, i cili kushtëzon qytetarët e Vushtrrisë për të paguar obligimet ndaj kompanisë “Uniteti” në Vushtri, duke shtuar se ka filluar të zbatohet pa mbështetje ligjore, sepse duhet të plotësohen disa kondita të propozuara nga kryetari i komunës, e që kuvendi i ka përkrahur, prandaj kërkoi që të mos zbatohet vendimi në fjalë, pasi që është në kundërshtim me ligjin. Në vazhdim në emër të Grupit parlamentar të LDK-së kërkoi përgjigje me shkrim për këto çështje: Projektet kapitale të realizuara gjatë vitit 2011, vetëm ato projekte për të cilat është hartuar projekti kryesor (jo paramasë dhe paralogari); Për secilin projekt të ceket kompania projektuese dhe vlera kushtuese e projektit; Të ceken projektet e realizuara nën mbikëqyrjen e kompanisë që është paguar për mbikëqyrje dhe njëkohësisht të ceket vlera kushtuese e mbikëqyrjes për secilin projekt; Informatë lidhur me masat e ndërmarra lidhur me dy rrugët e potencuara në mbledhjen e KK-së të dt. 31.05.2012 (rruga Sllatinë-Tërllabuq dhe stacioni i trenit-Bukosh), pasi që këto rrugë janë në gjendje të mjerueshme.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- duke iu referuar rrugës Sllatinë-Tërllabuq dhe stacioni i trenit-Bukosh, tha se janë duke u zhvilluar të gjitha procedurat për ta paditur kompaninë për shkak se nuk i ka kryer punët siç duhet.

Veli Karaça, anëtar i kuvendit- lidhur me çështjen e pastërtisë së qytetit, pyeti se cilat janë rezultatet e aksionit të 24 majit për pastrimin e qytetit, dhe a është duke vazhduar në datën 24 të çdo muaji pastrimi i qytetit, pasi që me 24 maj kanë marrë pjesë shumë nxënës dhe janë humbur shumë orë mësimi, prandaj duhet të ketë edhe rezultate në këtë aksion. Pastaj lidhur me furnizimin me ujë të pijshëm, pyeti se a ka mundësi që kuvendi i komunës dhe kryetari i komunës të bëjnë presion te kompania publike që ata të kujdesen për shfrytëzim racional të ujit, duke shtuar se mungesa e furnizimit me ujë vjen si pasojë e humbjes së një pjese të ujit derisa të arrin në Vushtri, por edhe një pjesë shumë e madhe humbet brenda qytetit tonë, për shkak të shfrytëzimit joracional të ujit.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- tha se gjatë hartimit të ligjeve përkatëse për kompanitë publike duhet të kihet kujdes që në të ardhmen të mos mbesin kompani regjionale, dhe shtoi se ose duhet që të privatizohen kompanitë, ose duhet të kalojnë në kompani komunale, duke përfshirë edhe nevojën e domosdoshme që edhe kompania e ujësjellësit të kalojë në kompani komunale, sepse në këtë mënyrë më nuk mund të funksionohet. Ndërsa lidhur me aksionin e 24 majit, tha se higjiena nuk mbahet me aksione, por higjiena mbahet në mënyrë institucionale dhe ligjore, por në veçanti kompania që menaxhon higjienën në komunë çdoherë duhet t’i përsos metodat e punës.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- tha se e mbështet propozimin e fundit që e bëri kryetari i komunës, por nuk e mbështet premtimin që ka bërë për ujë, pasi që ujë nuk kemi, prandaj propozoi që të gjendet një strategji (derisa të ndërtohet fabrika e ujit) për të furnizuar qytetarët me ujë përmes “autobotëve” apo formave tjera. Kurse lidhur me pastërtinë në qytet, tha se duhet të ketë angazhim të gjithanshëm nga të gjithë qytetarët, por qeveria komunale duhet t’i prijë në mënyrë që të mbahet pastërtia e qytetit, në mënyrë që të mos kemi një ambient të padurueshëm. Pastaj duke iu referuar Kullës së Azem Galicës, kërkoi që të angazhohemi të gjithë për ta

ruajtur kullën në fjalë, pasi që janë shkatërruar shumë kulla dhe monumente tjera, prandaj propozoi që komuna t'i ruajë këto monumente siç duhet.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- duke iu referuar çështjes së furnizimit të qytetarëve me ujë, tha se në këtë vit fabrika e ujit do të përfundojë, duke shtuar se ka mundësi që vitin e ardhshëm qytetarët e Vushtrrisë të furnizohen me ujë. Kurse duke iu referuar Kullës së Azem Galicës, propozoi që të punësohet një anëtar nga familja e Azem Galicës, i cili do ta luante rolin e ciceronit. Në fund propozoi që një rrugë e cila kalon nga Galica në Prekaz të asfaltohet, pasi që ajo rrugë mundëson lidhjen me Kompleksin e Jasharëve, në mënyrë që në të ardhmen Galica të bëhet pikë turistike.

Mbledhja përfundoi në orën 12:13.

**Procesmbajtësi
Albanez Tahiraj**

**Kryesuesi i Kuvendit
Habib Mustafa**

**Lektore
Vlora Krasniqi**